

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-235/13

Prishtinë/Priština,  
14 Janar 2015

Në çështjen juridike të:

**P. Đ. B.**

*Appellant*

kundër

**N.Q.**

*Pala ankuese*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejma Nuredini, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA30017), të datës 22 tetor 2012 dhe KPCC/D/A/172/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA90744), të datës 24 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 Janar 2015, mori këtë:

### AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga P. Đ. B., të datës 12 gusht 2013, të regjistruar me numrat GSK-KPA-A-235/2013 dhe GSK-KPA-A-236/2013, janë bashkuar si një lëndë e vetme me numrin GSK-KPA-A-235/2013.
2. Hidhet poshtë si e paafashme ankesa e P. Đ. B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA30017, i datës 22 tetor 2012.
3. Refuzohet si e pabazuar ankesa e P. Đ. B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/172/2012 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA90744, i datës 24 tetor 2012.
4. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/172/2012 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA90744, i datës 24 tetor 2012.

#### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 20 shkurt 2007, paraqitësi i kërkesës Đ. P. B., ka paraqitur dy kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar njohjen e së drejtës së tij pronësore dhe ririposimin e ngastrave kadastrale nr. 732, në sipërfaqe prej 0ha 9ar 54m<sup>2</sup>, dhe ngastrës kadastrale nr. 942, në sipërfaqe prej 0ha 59ar 24m<sup>2</sup>, fleta poseduese nr. 518, zona kadastrale Xërxe/Zrce, komuna e Rahovecit/Orahovac. Ai pretendon se është pronar i 1/3 të pjesës ideale të pronave të kërkuara në Xërxe/Zrce, të cilat i ka trashëguar nga babai i tij P. S.B., pas përfundimit të procedurës trashëgimore.
2. Gjatë periudhës së pranimit të kërkesës ai ka deklaruar se pronat janë humbur për shkak të rrethanave që rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë në vitet 1998/99. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës në deklaratën e tij pranë Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, më 14 qershor 2012, e pranon se familja e tij është larguar nga Kosova për në Mal të Zi dhe Serbi në vitin 1967 dhe qysh atëherë nuk i kishte në posedim pronat e kërkuara. Në vazhdim ai ka thënë se në vitin 1997 ai i kishte marrë pronat në bazë të vendimit të gjykatës.

3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, D. P. B. (në tekstin e mëtejme paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kopje të fletës poseduese nr. 518, komuna kadastrale Xërxe/Zrze, e lëshuar më 29 gusht 2002 nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi e komunës së Rahovecit/Orahovac, që përmban ngastrat kadastrale me nr. 732 dhe 942. Paraqitësi i kërkesës po ashtu ka paraqitur një kopje të aktgjykimit P.br.165/97, të lëshuar më 29 shtator 1997, nga Gjykata Komunale e Rahovecit/Orahovac, me të cilin është vendosur se kontrata për shitblerje OV.br.129/67 e lidhur më 14 qershor 1967 në Rahovec/Orahovac, në mes të babait të tij P. S.B.(në tekstin e mëtejme BDP) dhe Komunës së Rahovecit/Orahovac, për sa i përket pronave të kërkuara, është anuluar. Ky është aktgjykimi në bazë të cilit paraqitësi i kërkesës dhe dy vëllezërit e tij e kanë rifituar të drejtën e posedimit të 1/3 së pjesës ideale të pronave të kërkuara. Në vazhdim është ofruar një kopje e aktgjykimit O.br.75/98, i lëshuar më 17 mars 1996 nga Gjykata e Qarkut në Prizren, që tregon se vërtetohet aktgjykimi i GJK-së në fjalë.
4. Më 8 shkurt 2010 dhe 18 korrik 2012, AKP-ja ka vërtetuar saktësinë e njoftimit të pronave të kërkuara-ngastrat nr. 732 dhe nr. 942 me hartë kadastrale, ortofoto dhe koordinata të GPS.
5. Më 7 shtator 2007, AKP-ja e ka verifikuar pozitivisht fletën poseduese nr. 518, të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës. Aktgjykimi P.br.165/97 i GJK-së në Rahovec/Orahovac, dhe aktgjykimi O.br.75/98 i GJQ-së në Prizren, po ashtu janë verifikuar. Sekretaria Ekzekutive ka vërtetuar *ex officio* se të dyja ngastrat janë regjistruar në emër të disa bashkë-pronarëve, trashëgimtarë të P.S. B.
6. Pala përgjegjëse në kërkesë N. Q. ka paraqitur një njoftim për pjesëmarrje në procedurë më 19 dhjetor 2008. Ai ka kërkuar të drejtën pronësore ndaj pronave të kërkuara. Përveç letërnjoftimit të tij nuk ka asnjë dokument tjetër në dosje të lëndës të paraqitur nga ai. Vëllai i palës përgjegjëse në kërkesë, M. Q., në korrespondencën e tij me AKP-në ka deklaruar se: “*[...në vitin 1967 Fondacioni i Gjenezës për Migrantë e ka blerë tokën nga babai i paraqitësit të kërkesës në shumën prej 12 milion...]*”. Për më tepër ai ka thënë se: *[...Prej 1967, deri sot, ne e kemi posedimin dhe pronësinë ndaj kësaj toke ...këtyre ngastrave: 732....942...]*”.
7. Nuk është kontestuese se familja e paraqitësit të kërkesës i ka shfrytëzuar këto prona deri në vitin 1967.
8. Nuk është e kundërshtueshme se pas vitit 1967 dhe para konfliktit të armatosur në vitet 1998/1999, prona është shfrytëzuar nga persona tjerë.
9. Është jo relevante për lëndën aktuale se në çfarë baze, ata individ i kanë shfrytëzuar pronat në fjalë pas vitit 1967 deri në konfliktin e armatosur.
10. Me vendimet grupore: KPCC/D/R/175/2012, i datës 22 tetor 2012, dhe KPCC/D/A/172/2012, i datës 24 tetor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPP) i ka hedhur poshtë kërkesat në bazë të “dokumenteve të ndryshme të paraqitura nga

- paraqitësi i kërkesës, të cilat janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së *ex officio* dhe në bazë të deklaratës së vet paraqitësit të kërkesës të dhënë në AKP që konstaton se prej 1967 ata nuk kanë jetuar në Kosovë”. Në vështrim të kësaj, Komisioni ka vërtetuar se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin si rezultat i konfliktit në vitet 1998/99, por për shkak të rrethanave tjera para kësaj periudhe. Prandaj, kërkesat nuk janë në kuadër të juridiksionit të Komisionit, dhe si rrjedhojë janë hedhur poshtë.
11. Vendimet i janë dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 18 prill 2013 (KPCC/D/R/175/2012) respektivisht më 15 korrik 2013 (KPCC/D/A/172/2012). Ai ka paraqitur ankesat më 12 gusht 2013.
  12. Vendimet i janë dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë më 25 prill 2013 (KPCC/D/R/175/2012) respektivisht më 16 korrik 2013 (KPCC/D/A/172/2012). Më 12 dhjetor 2013, ai ka paraqitur përgjigje në ankesë duke deklaruar se qëndron pranë të gjitha deklaratave të dhëna pranë AKP-së.

**Pretendimet e palës ankuese:**

13. Djali i paraqitësit të kërkesës P. Đ. B.(ne tekstin e mëtejme, pala ankuese) e ka kundërshtuar vendimin e KKKP-së në tërësi, duke pretenduar se babai i tij i ndjerë ishte pronari i pronave të kërkuara. Në vazhdim, në deklaratën e tij me shkrim të bashkëngjitur si një pjesë tjetër integrale e ankesave lidhur me pronat e paluajtshme të regjistruara në fletën poseduese nr. 518 dhe në certifikatën e të drejtave të pronës së paluajtshme UL-71510033-00518, të lëshuar më 3 korrik 2012 nga Komuna e Rahovecit/Orahovac, ku përveç pronave tjera janë të regjistruara gjithashtu edhe ngastrat e kërkuara nr. 732 dhe ngastra nr. 942, pretendon se qysh nga viti 1932 pronari i pronave të kërkuara ishte gjyshi i tij P. S. B. (në tekstin e mëtejme, bartësi i së drejtës pronësore (BDP)). Ai shtoi se BDP ishte nën presion dhe kërcënim që t’i shiste pronat e kërkuara; prandaj, kontrata e shitblerjes OV.br.129/67 në mes të BDP-s dhe Komunës së Rahovecit/Orahovac është e lidhur me detyrim më 14 qershor 1967. Pala ankuese po ashtu ka deklaruar se paraqitësi i kërkesës dhe vëllai i tij si trashëgimtarë të BDP kanë ngritur padi pranë Gjykatës Komunale në Rahovec/Orahovac, ku kanë kërkuar nga gjykata anulimin e kësaj kontrate të shitblerjes dhe deklarimin e cilit prej tyre pronar të 1/3 së pjesës ideale. Pala ankuese pretendon se shfrytëzimi i pronave të kërkuara nga familja Q. është bërë pa bazë ligjore, që paraqet shkelje të të drejtave të njeriut.

**Arsyetimi ligjor:**

**Bashkimi i ankesave:**

14. Gjykata i referohet nenit 408.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejme, LPK), i aplikueshëm *mutatis mutandis* (përshtatshmërisht) në procedurën pranë Gjykatës Supreme (neni 12.2 i Ligjit 03/L-079). Kjo i ofron gjykatës mundësinë e bashkimit të procedurës nëse bashkimi i tillë i procedurës kontribuon në efikasitetin e atyre procedurave.
15. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme gjen se e tërë baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave janë tërësisht të njëjta në këto dy lëndë. Vetëm ngastrat e kërkuara në të dyja kërkesat janë të ndryshme.
16. Lëndët e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-235/2013 dhe GSK-KPA-A-236/2013 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar me numrin GSK-KPA-A-235/2013.

**Pranueshmëria e ankesave:**

17. Gjykata Supreme e ka juridiksionin ndaj ankesave kundër vendimit të KKKPK-së..

**Lënda GSK-KPA-A-235/2013 (KPA30017):**

18. Ankesa në lëndën KPA30017 është e papranueshme sepse është paraqitur jashtë kornizës ligjore në përputhje me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079) për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, që parashihet se: *“brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.
19. KKKPK-ja ka vendosur për këtë lëndë me vendimin e vet KPCC/D/R/175/2012 të datës 22 tetor 2012. Ky vendim i është dorëzuar palës ankuese më 18 prill 2013. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesë vetëm më 12 gusht 2013. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1 (a) të LPK-së, ankesa është dashur të hidhet poshtë si e paafatshme.
20. Gjykata nuk ka mundur të gjejë asnjë arsye se pse pala ankuese duhet të arsyetohet për këtë vonesë. Ai është njoftuar sa duhet rreth afatit të fundit (vendimi përmbante një njoftim në gjuhën serbe) dhe vet pala ankuese nuk dha asnjë arsyetim rreth vonesës.

**Lënda GSK-KPA-A-236/2013 (KPA90744):**

21. Ankesa në lëndën KPA90744 është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.
22. Ankesa është e pabazuar.
23. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, Komisioni ka kompetencë të zgjidhë kërkesat që ndërlidhen me konfliktin e viteve 1998/1999, që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore të cilat nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
24. Në lëndën aktuale posedimi i pronave është humbur në vitin 1967 (vetë paraqitësi i kërkesës e pohon këtë fakt). *D.m.th* kërkesa nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur në vitet 1998/1999. Prandaj, Komisioni me të drejtë e ka hedhur poshtë ankesën pasi është jashtë juridiksionit të vet.
25. Në bazë të të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195.1 (a) dhe (d) Gjykata vendosi si në dispozitiv.

**Këshillë ligjore:**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Elka Ficheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Esma Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it**

**SylejmanNuredini, Gjyqtar**

**Urs Nuffer, Referenti i EULEX-it**